

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Çmimi i lartë i naftës, qeveria rikthen Bordin e Transparencës dhe uljen 20% të akcizës! Miratohet pr.ligji për 'krijimin e rezervës hidrokarbure', në dorë të shtetit - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/cmimi-i-naftes-qeveria-rikthen-bordin-e-transparences
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 10:44:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 10:40:23 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5844fcb17cdc7e8da79d2b42218f184ddf6ac1060d02a32dd576344cf9a68b0a
TEKSTI	2da81cf01180c1d391cda011d20842886501d78c409d68d39b75172ed7a39650
PAMJA	4e8cc7f9b3310df248f3084680436de95ff73f9744f5f29a375c7803868bee2a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	78fc92bd6618f20b972d954a2e79c469a3b206353c8672f2f94a3e5903f44428
E MËPARSHMJA	b2446357beb2f7420df2e6f0943c950f3c62a2a33e362c6a1e611b1908fca220
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/78fc92bd6618f20b972d954a2e79c469a3b206353c8672f2f94a3e5903f44428>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Flash

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Vizita në SHBA, Rama me diasporën në Michigan: S'jemi më vend mbijetese, por shprese! Objektivi ynë, BE në 2030! Kryeministri merr dedikimin e veçantë (VIDEO)

Ekonomi

Çmimi i lartë i naftës, qeveria rikthen Bordin e Transparencës dhe uljen 20% të akcizës! Miratohet pr.ligji për 'krijimin e rezervës hidrokarbure', në dorë të shtetit

Tre muaj pas shpërndarjes, qeveria rikthen sërish bordin e Transparencës. Në përgjigje të shtrenjtimit të karburantit me gati 30% nga muaji qershor, qeveria do të ulë me 20% akcizën sa herë që çmimi i naftës kapërcen 220 lekë/litër, dhe benzina mbi 200 lekë. Këshilli i Ministrave miratoi edhe projektligjin për krijimin e rezervës së naftës për 3 muaj.



Eliza Gjeditu

16 Shtator, 12:39 | Përditësimi: 16 Shtator, 14:59

f Share Tweet



Më 19 qershor, pas 3 muajve në fuqi, qeveria shpërndau bordin e Transparencës. Sot, pas 3 muajsh, kur çmimi i naftës ka arritur në 229 lekë për litër dhe benzina 219 lekë, qeveria rikthen Bordin, për të caktuar çmimet e karburantit në vend



"Afati është deri në përfundimin e vlerësimit tonë mbi nevojën për të pasur bordin", tha Ibrahimaj.

Ministria e Ekonomisë [Delina Ibrahimaj](#) tha se paralelisht, do të ulet me 20% edhe akciza për karburantin sa herë që çmimi i naftës me pakicë do të kalojë 220 lekë për litër, dhe i benzinës mbi 200 lekë.



LEXO EDHE:

Shteti 90 ditë naftë rezervë në rast krize! Do krijohet me një tarifë të re që rrezikon rritjen e çmimit për konsumatorët



"Duke qenë se kemi marrë një vendim paraprakisht, ku sa herë çmimi të kalojë 220 lekë, ne do të aktivizojmë një mekanizëm, për reduktimin e akcizës me qëllim që çmimi të reduktohet, mekanizmi i vetëm me të cilin ne mund të aktivizojmë këtë mekanizëm, ishte ringritja e bordit të Transparencës". tha Ibrahimaj.

Me këtë reduktim vlera e akcizës në një litër [naftë](#) dhe benzinë ulet në 31.5 lekë nga 38.8 lekë që është kjo taksë.

Përveç akcizës, ulet automatikisht edhe TVSH-ja që është taksë fundore që paguhet në një litër naftë. Në tre muaj që ishte në fuqi [Bordi i transparencës](#) nga marsi deri në qershor, ndërhyri në treg 37 herë.

Gjithashtu qeveria ka miratuar edhe projektligjin për rezervën e sigurisë hidrokarbure, duke e kaluar nga privati, te shteti.



"Mbajtja e rezervës së hidrokarbureve është kur në treg ka pasiguri për produktin, apo kur produktet në treg mungojnë. Ky ligj i ri krijon detyrimin e ruajtjes së rezervës, duke e menaxhuar dhe e hedhur herë pas here në treg për të mos humbur cilësitë ekonomike", tha ministri i Energjetikës, Enea Kakaçiqi.

Rezerva e naftës duhet të garantojë për të paktën 90 ditë furnizim, ndërsa detajet e sigurimit të sasisë së naftës do të caktohen me VKM. Kjo rezervë shtetërore do të menaxhohet, administrohet, magazinohet dhe shitet nga Autoriteti për Rezervën e Sigurisë të Naftës.

Share

S.I.E./E.H/Shqiptarja.com

TAG: [naftë](#) [Enea Karakaçi](#) [ritja e cmimit të naftës](#) [bordi i transparencës](#) [Delina Ibrahimaj](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ 3.0 / 5 (4 vlerësime)

☐ LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komente

Eva: 18/09/2026 18:43

Turp shume turp Shqipnia,Mali zi ka cmime karburantit shume mira.Nafta (Eurodiesel): Kushton 1.90 €/litër (përafërsisht 176 lekë).Benzina Eurosuper 95: Kushton 1.72 €/litër (përafërsisht 160 lekë).Benzina Eurosuper 98: Kushton 1.76 €/litër (përafërsisht 163 lekë).Krahasuar me Shqipërinë (ku nafta tregtohet rreth 229 lekë ose ~2.46 €), furnizimi në Malin e Zi është dukshëm më i lirë me rreth 0.50 deri në 0.70 euro më pak për çdo litër. Qeveria malazeze ka aplikuar ulje të njëpasnjëshme të akcizës për të frenuar rritjen e çmimeve nga bursa

Përgjigju

Çudi: 18/09/2026 13:20

Pse nuk te habit Çeti qe s'gopet me leket tona dhe magjistratet po?

Përgjigju

Beni: 16/09/2026 19:48

Tallje mendereje me pak fjale

Përgjigju

© Ndalohej reprintsisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës: 16 Shtator, 14:18
Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

☐ Të drejtë ☐ Të gabuar ☐ Nuk e di

Lajme të tjera



Bordi cakton çmimet e karburanteve! Nafta do të shitet me 219 lekë/litri, benzina me 195 lekë/litri

19 Shtator, 10:33



Karakaçi: Prodhimi total i energjisë nga impiantet fotovoltaike deri në fund të gushtit arriti në 868 giga!

18 Shtator, 15:31



Çmimet e shportës/ Rama-supermarketeve: Ulini, ose do të thoni 'ç'ha u desh fitimi!' Marzhe të papranueshme

18 Shtator, 15:27



Ndërtimi i bypass-it të Elbasan, Karakaçi: Kushton 240 mln €, do financohet edhe nga buxheti i shtetit



Eliza Gjedić

17 Shtator, 17:14



Çmimi i lartë i naftës, hyn në fuqi vendimi për rikthimin e Bordit të Transparencës! Pritet edhe ulja me 20% të akcizës!

17 Shtator, 15:47



Bonusi mujor për pensionistët dyfishohet nga 1 janari 2027, Ibrahimaj: Objektivi ynë pension minimal 40 mijë lekë deri në 2030 (VIDEO)

15 Shtator, 15:52



Çmimi i naftës, PD: Qeveria të ndërhyjë, të 'zhveshë' dieselin nga barrat fiskale (VIDEO)

15 Shtator, 11:35



Nafta po shitet me 229 lekë litri, Braçe: Edhe Kosova furnizohet nga të njëjtët shitës që na shesin edhe ne, por nuk e ka rritur çmimin (VIDEO)

13 Shtator, 18:12



Çmimi i naftës tjetër rekord, po shitet me 229 lekë litri! Nga qershori deri më tani është shtrenjtuar me 30%



Eliza Gjedić

13 Shtator, 17:58



Strehim me kredi të buta/ Ibrahimaj: Jo program elektorale, miratohet në tetor! S'ka rikthim të Bordit të Transparencës (VIDEO)




Eliza Gjedić

11 Shtator, 10:54



Qeveria shpall fituesit e programit për përmirësimin e banesave, Ibrahimaj: 700 milionë lekë për 663 familje në nevojë

10 Shtator, 13:41



Qeveria program të ri strehimi, 4000 kredi të buta për çiftet e reja në 2027, gjysma e tyre me 0% interes! Subvencionohet qiraja për 3 mijë familje

10 Shtator, 13:35



[Kodi Etik](#)

[Kontakt](#)

[Rreth Nesh](#)

[Raportoni Ju](#)

[Puno me ne](#)

[Shqiptarja.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.